 KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F3
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 1 nga 2

Përshkrimi i detyrave të punës

Pozita	Trajner i programit të trajnimit “Drejtat e Njeriut/Fëmijës”
Kodi dhe emërtimi i aktivitetit	A1.1- Organizimi i trajnimeve me ekipet për parandalim dhe referim të dhunës brenda shkollave në komunat Kamenicë, Ferizaj dhe Vushtrri.
Zëri buxhetor i aktivitetit	ZB:31
Numri i ditëve të punës	32 ditë pune (8 ditë pune për trajner)
Periodha e angazhimit	29 qershor 2020 - 31 korrik 2020

Qëllimi i angazhimit të trajnerëve

Organizimi i trajnimeve me ekipet për parandalim dhe referim të dhunës brenda shkollave në komunat Kamenicë, Ferizaj dhe Vushtrri.


Përshkrimi i projektit

Projekti TACA-“Së bashku kundër abuzimit të fëmijës”, është projekt i cili implementohet nga Qendra për Arsim e Kosovës në partneritet me Qendra për Studime të Avancuara (FIT), dhe financohet nga Bashkimi Evropian. Ky projekt ka për qëllim të siguroj që të gjithë fëmijët të trajtohen me respekt të plotë për dinjitetin për të drejtat e tyre duke promovuar mjedisin pa abuzim në shkollat e Kosovës. Projekti do të realizohet në shkollat e komunave: Ferizaj, Kamenice dhe Vushtrri, i cili përbëhet nga ka tri komponentë: 1. Përkrahjen e autoriteteve dhe shkollave për t'u marrë me të gjitha llojet e rreziqeve që lidhen me abuzimin ; 2. Edukimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve për të parandaluar abuzimin e fëmijëve në shkolla dhe t'i përgjigjen abuzimit në një mënyrë të përshtatshme dhe 3. Ngritjen e vetëdijes ku përmes aktiviteteve të shumta rrisim ndjeshmërinë e njerëzve ndaj problemit.

Përshkrimi i hollësishëm i detyrave të punës

Qëllimi i angazhimit të trajnerëve është ofrimi i trajnimeve me ekipet për parandalim dhe referim të dhunës brenda shkollave në komunat Kamenicë, Ferizaj dhe Vushtrri. Trajnerët do të punojnë në çift, duke ndarë detyrat dhe obligimet e tyre sipas kërkesave të programit të trajnimit.

Angazhimi për trajnerë përfshinë aktivitetet në vijim:

	PËRSHKRIM I DETYRAVE TË PUNËS		F3
	Prishtinë	v. 1.0	Faqe 2 nga 2

- Organizimi i takimeve dhe ndarja e detyrave mes trajnerëve;
- Bashkëpunimi me anëtarët e ekipit brenda shkollës për të ofruar trajnime të cilat mbështeten në praktikat më të mira;
- Hartimi i agjendës dhe zhvillimi i materialeve tërheqëse dhe ndërvepruese për grupet që trajnohen;
- Përgatitja dhe udhëheqja e trajnimeve duke iu përmbajtur agjendës dhe obligimeve të kërkuara nga grupet që trajnohen;

Trajnimet kanë kohëzgjatjen dy ditore për një grup të trajnimit.

Kualifikimet për trajnerët:

- Kualifikim i nivelit baçelor, preferohet niveli master;
- Njohuri të mjaftueshme të të Drejtave të Njeriut/Fëmijës.
- Eksperiençë e mjaftueshme në zhvillim organizimin e trajnimeve me fëmijë dhe të rritur;
- Aftësi për të zgjidhur probleme emergjente teknike dhe për të ndarë mësim dhe sugjerime me ekipin që të arrihet në një zgjidhje të shpejtë sipas nevojës;
- Dëshmi të aftësimi (certifikatë) si trajner në këtë fushë.
- I/e gatshëm të punojë në orar fleksibil dhe të zgjatur sipas nevojës;

Raportimi

Trajneri i raporton menaxherit të projektit Ardita Kabashi.

Programet e trajnimit rishikohen, monitorohen dhe aprovohen nga menaxheri i projektit. Aprovimi i timesheetave nga menaxheri i projektit nënkupton edhe përmbylljen e suksesshme të kontratës.

Raportet e trajnimit duhet të dorëzohet në formë elektronike në gjuhën shqipe më së largu një javë pas përfundimit të trajnimit.